



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**PA1 Nr. 03-537**  
**17.11.2023**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 80 paragrafët (7), (8) dhe (9) të Ligjit të njëjtë, pika 4 të Drejtimeve për regjistrimin vullnetar të radiostacioneve për transmetimin e muzikës vendase ark.nr.01-546/1 datë 04.02.2019, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3647/1 datë 04.10.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4225/5 datë 16.11.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 37-të mbajtur më 16.11.2023, miratoi si vijon:

**Aktvendim**  
**për ndërmarrje të masës - vërejtje publike**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) SKAJ RADIO Teodor SHPKNJP - Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 80 paragrafët (7), (8) dhe (9) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), si dhe në lidhje me pikën 4 të Drejtimeve për regjistrimin vullnetar të radiostacioneve për transmetimin e muzikës vendase, të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit të vet programor në radio më 4 shtator 2023, nuk ka transmetuar së paku 10% të muzikës në gjuhën maqedonase në periudhën nga ora 06:00 deri në orën 00:00, nga totali i muzikës së transmetuar të analizuar gjatë një ditë-nate.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-3647/1 datë 04.10.2023, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR SKAJ RADIO Teodor SHPKNJP-Shkup që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat nga LSHMAAV dhe Drejtimit për regjistrimin vullnetar të radiostacioneve për transmetimin e muzikës vendase.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe si ditë për miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

## Ar sy et im

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV është kompetente për të kryer mbikëqyrje kontrolli (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të Shërbimeve Mediatike Audiovizuale sipas kërkesës, si dhe të paketave programore të ritransmetuara nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji i cituar, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masën - vërejtje publike në rastet kur është konstatuar mos respektim, cënim ose shkelja e dispozitave nga LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me leje dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 80 paragrafi (7) të LSHMAAV, shoqëritë tregtare radiodifuzive që transmetojnë program në radio dhe që në fillim të vitit kalendarik do t'i raportojnë vullnetarisht Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale përqindje të transmetimit të muzikës në gjuhën maqedonase dhe bashkësitë etnike, për të njëjtën përqindje do të kenë zbritje në shumën e kompensimit (tarifës) për leje. Ulja minimale e tarifës së lejes mbi këtë bazë mund të jetë 10%, dhe ulja maksimale deri në 30%. Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë program në radio dhe që transmetojnë muzikë më shumë se 30% në gjuhën maqedonase dhe të bashkësitë etnike nuk mund të kenë ulje të tarifës së lejes për më shumë se 30% (neni 80 paragrafi (8) nga LSHMAAV). Këshilli i Agjencisë, në pajtim me nenin 80 paragrafi (9) nga Ligji i njëjtë, do të sjell aktvendim me të cilin do të përcaktojë plan për kohën dhe zhanrin e transmetimit të muzikës në gjuhën maqedonase dhe të bashkësive etnike për shoqëritë tregtare radiodifuzive që transmetojnë program në radio.

Këshilli i Agjencisë më datë 04.02.2019 miratoi Udhëzimin për regjistrimin vullnetar të radiostacioneve për transmetimin e muzikës vendase, ark.nr.01-546/1 datë 04.02.2019, i cili përcakton mënyrën e zbatimit të nenit 80 paragrafët (7) (8) dhe (9) të LSHMAAV, të cilat u mundësojnë shoqërive tregtare radiodifuzive që transmetojnë programe në radio, të marrin ulje për shumën e kompensimit (tarifës) për leje transmetimi në radio në pajtim me përqindjen e muzikës instrumentale të autorëve maqedonas, vokal dhe/ose vokale-muzikë instrumentale në gjuhën(t) në të cilën/të cilat do të transmetohet pjesa folëse e programit, të raportuar që do ta transmetojnë gjatë ditës. Në pajtim me pikën 14 të Drejttimeve për regjistrimin vullnetar të radiostacioneve për transmetimin e muzikës vendase, ato janë publikuar në ueb faqe të Agjencisë më 04.02.2019.

Në pikën 4 të Udhëzimit për regjistrimin vullnetar të radiostacioneve për transmetim të muzikës vendase, është përcaktuar se shërbimet programore në radio janë të obliguara që përqindjen e raportuar të muzikës në gjuhën maqedonase dhe në gjuhët e bashkësive etnike ta transmetojnë çdo ditë, në periudhën nga ora 6 deri në orën 00.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për Çështje Programore, më 4 tetor 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore, dhe ka konstatuar se më 4 shtator 2023, shërbimi programor në radio i SHTR SKAJ RADIO Teodor SHPKNJ - Shkup, ka bërë shkelje të nenit 80 paragrafët (7) (8) dhe (9) të LSHMAAV, dhe në lidhje me pikën 4 të Udhëzimit për regjistrimin vullnetar të radiostacioneve për transmetimin e muzikës vendase, gjegjësisht se nuk ka transmetuar së paku 10% të muzikës në gjuhën maqedonase në periudhën nga ora 6 deri në ora 00, nga totali i muzikës së transmetuar e analizuar gjatë një ditë-nate.

Me shkresë, nr.y në ark.03-4676/1 të datës 19.12.2022, SHTR SKAJ RADIO Teodor SHPKNJ-Shkup ka njoftuar Agjencinë se në bazë ditore do të transmetojë 10%

muzikë në gjuhën maqedonase dhe të bashkësive etnike në Republikën e Maqedonisë. Në bazë të njoftimit të pranuar dhe në pajtim me nenin 80 paragrafi (7) të LSHMAAV, Agjencia ka dhënë faturë nr. 2023-100-0042 (nr.ynë ark 05-150/1) datë 12.01.2023, në të cilin është llogaritur ulje prej 10% e kompensimit (tarifës) së lejes për transmetim në radio për vitin 2023.

Në pajtim me nenin 80 paragrafi (9) të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në Udhëzimin për regjistrimin vullnetar të radiostacioneve për transmetimin e muzikës vendase, Këshilli i Agjencisë ka përcaktuar se shërbimet programore në radio janë të obliguar përqindjen e raportuar muzikë në gjuhën maqedonase dhe në gjuhët e bashkësive etnike, të transmetohet gjatë ditës, në periudhën nga ora 6 deri në ora 00, me kritere zhanri siç është raportuar në konceptet programore që janë pjesë përbërëse e lejeve për transmetim në radio.

Duke pasur parasysh se SHTR SKAJ RADIO Teodor SHPKNJ - Shkup ka leje për transmetimin e programit në gjuhën maqedonase, detyrimi i marrë vullnetarisht për transmetimin e muzikës vendase duhet të realizohet duke transmetuar muzikë vokale dhe/ose vokalo-instrumentale në gjuhën maqedonase dhe/ose transmetim të muzikës instrumentale të autorëve nga Republika e Maqedonisë së Veriut.

Me mbikëqyrjen e kryer më 4 tetor 2023 është konstatuar se shërbimi programor në radio i Shoqërisë tregtare radiodifuzive SKAJ RADIO Teodor SHPKNJ – Shkup, më 4 shtator ka transmetuar gjithsej 2 orë 37 minuta e 47 sekonda muzikë vokale dhe/ose vokalo-instrumentale në gjuhën maqedonase, që është 12.51%. nga totali i muzikës së transmetuar (21 orë e 49 sekonda) në ditë-natën e analizuar.

Në periudhën nga ora 6 deri në ora 00, siç përcaktohet në pikën 4 të Udhëzimit të miratuar nga Këshilli i Agjencisë, u transmetua për 1 orë 54 minuta e 35 sekonda muzikë vokalo-instrumentale në gjuhën maqedonase, që është 9,09% nga totali i muzikës së transmetuar (21 orë e 49 sekonda) në ditë- natën e analizuar.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-3647/1 datë 04.10.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR SKAJ RADIO Teodor SHPKNJ - Shkup, dërgoi Shkresë ark.nr.10-3647/2 datë 09.10.2023, me të cilin ka dorëzuar Raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr. 10-3647/1 datë 04.10.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzojë deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe Udhëzimit për regjistrimin vullnetar të radiostacioneve për transmetimin e muzikës vendase. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 10.10.2023. Në afatin e paraparë, SHTR SKAJ RADIO Teodor SHPKNJ - Shkup nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të Ligjit. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 16.11.2023, e shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konstatoi që SHTR SKAJ RADIO Teodor SHPKNJ - Shkup t'i shqiptohet masë - vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, neni 80 paragrafët (7), (8) dhe (9) nga Ligji i njëjtë, si dhe në lidhje me pikën 4 të Udhëzimit për regjistrimin vullnetar të radiostacioneve për transmetimin e muzikës vendase, pika 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masave (Tekst i pastruar) dhe Raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore nr.10-3647/1, datë 04.10.2023, për konstatim të mos espektimit të dispozitave të LSHMAAV, dhe në lidhje me pikën 4 të Udhëzimit për regjistrimin vullnetar të radiostacioneve për transmetimin e muzikës vendase, përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 37-të mbajtur më 16.11.2023, në pajtim me konkluzionin ark.nr.02-4225/5 datë 16.11.2023, miratoi Aktvendim me të cilën publikisht

paralamërohet SHTR SKAJ RADIO Teodor – Shkup dhe obligohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat nga LSHMAAV dhe Udhëzimin për regjistrimin vullnetar të radiostacioneve për transmetimin e muzikës vendase. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 paragrafët (1) dhe (2) të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

**Shtojcë (1):**

- Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.10-3647/1 datë 04.10.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.